

**AKTI THEMELIMI**  
1  
**SHOQERISE ANONIME**  
**"WONDER" sh.a.**

**NENI 1:**

Në bazë të ligjit Nr. 7512 datë 10/08/1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarisë private të pavarur dhe privatizimit", Ligjit Nr. 7638 datë 19/11/1992 "Për shoqëritë tregtare" si dhe të Ligjit 7667 datë 28/01/1993, "Për Regjistrimin e shoqërive në Regjistrin Tregtar", me vullnetin e tij të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, themeluesi:

1. **Vasil Gjika**, i biri i Nikos, lindur me 19.02.1955 ne Permet, banues ne Tirane ne 'Rr. « Leke Dukagjini », Pallati Perballe INIMA-, me shtetesi Shqiptare, deklaron se ka nënshkruar kete kontrate dhe ka rene dakort per krijimin e nje shoqerie anonime ne baze te ketij akti themelimi si dhe statutit, duke respektuar edhe kerkesat e legjislacionit shqiptar per shoqerite tregtare.

**NENI 2:**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

Emri i shoqerise do te jete: **"WONDER" sh.a.**

**NENI 3:**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

**Objekti i veprimtarise se "Wonder" sh.a. do te jete:**

- Importimi, eksportimi dhe tregtimi me shumice dhe me pakice i te gjitha llojeve te artikujve.
- Zhvillimin e veprimtarise ne te gjitha fushat e ndertimeve, konstruksione, instalime, elektrike, hidrosanitare, ngrohje, rifinitura, etj, si dhe dhe tregtimin e te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit, elektrike, h/sanitare, ngrohje, etj..
- Projektimin dhe studimet ne te gjitha fushat e ndertimeve
- Projektimin dhe studimin ne fushen e urbanistikes.
- Zhvillimin e aktivitetit te investimit ne fushen e turizmit, transportit tokesor, ajror dhe detar
- Dhenia e konsulences dhe kryerja e sherbimeve ne lidhje me veprimtarite e mesiperme dhe ne te tjera.
- Studime te ndryshme feasibiliteti per projekte dhe investime ne sektore te ndryshem;
- Konsulence dhe asistence teknike per menaxhimin financiar te sipermarrjeve private dhe publike;
- Identifikim, hartim dhe zbatim projektesh e programesh ne nivel sipermarrjeje te vecante, qarku, kombetar dhe me gjere;
- Organizim ngjarjesh publike (seminare, workshop-e, kurse trajnimi, konferenca, etj.) per ceshtje te ndryshme te zhvillimit ekonomik, social, kulturor, politik; ndemarrje te fushatave te ndergjegjiesimit publik, etj.
- Konsulence ne lehtesimin e operacioneve te ndryshme bankare, tregtare, industriale, financiare, te pasurive te tundshme ose te patundshme, etj.,



- Kryerjen e supervizionit , kolaudimit, dhe observimin e te gjitha operacioneve ne fushen e ndertimit dhe urbanistikes.
- Manaxhimin dhe tregetin e trojeve te ndertimit dhe pasurive te patundshme
- Pervec veprimtarive te parashikuara me lart , ne veprimtarine sipermarrese te Shoqerise do te hyje cdo veprimtari tjeter industriale , tregtare , financiare, turistike dhe ndertimi qe do te konsiderohet nga Asambleja e Aksionereve e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te Shoqerise .

#### NENI 4

#### VENDODHJA E SELISE SE "WONDER" SH.A

"WONDER" sh.a. do ta kete seline e tij ne adresen si me poshte: Rr. «L. Dukagjini », Pallati perballe INIMA-s .. Ai mund te krijojë ose të mbyllë në Shqiperi ose jashte tij, përfaqësi apo seli të tjera.

#### NENI 5

#### KOHEZGJATJA E "WONDER" SH.A

Kohezgjatja e veprimtarisë së "WONDER" sh.a. do te jete mbi 10 vjet. Si ditë e fillimit të aktivitetit të tij do të merret data e regjistrimit në Gjykatën e Tiranës. Aksioneri i vetem ka të drejte të zgjasi këtë afat.

#### NENI 6:

#### KAPITALI I "WONDER" SH.A

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 12.000.000 (Dymbedhjete milione) leke. Kapitali ndahet në 100 aksione, me vlerë nominale 120.000 lekë sejcili, tërsisht i derdhur dhe i numeruar nga 1 deri në 100. Pjesmarria ne kapitalin themeltar e aksionerit është:

Nr	Emri Mbiemri	Nr. Aksioneve	Vlera Nominale	Kontributi ne Para
1	Vasil Gjika	100	120.000	12.000.000

Kapitali do të jetë kontribut në para dhe është i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

Themeluesi aksionar ka të drejtë ta zmadhojë dhe zvoglojë kapitalin e Shoqerise në para, ne perputhje me statutin e "WONDER" sh.a.. Në këtë rast, do të bëhen veprimet përkatëse për pjesmarrien e Aksionareve në kapitalin themeltar.

#### NENI 7:

#### VENDI I VEPRIMTARISE SE "WONDER" SH.A.

"WONDER" sh.a. do te ushtroje aktivitetin e tij ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

#### NENI 8:

#### FITIMI

Fitimet qe rezultojne nga aktiviteti i shoqerise do te ndahen mbasi te jene zbritur detyrimet ndaj te treteve dhe humbjet e mundeshme te viteve te meparshme, dhe pasi te jete lene shuma e fondit rezerve sipas percaktimit ne statut .

#### NENI 9:

#### FORMA JURIDIKE E "WONDER" SH.A

Forma juridike e shoqeriae do te jete Shoqeri Anonime pa oferte publike dhe emri i tij do te jete "WONDER" sh.a. dhe ne vazhdim do te referohet si "WONDER" sh.a

"WONDER" sh.a. nuk eshte pergjegjese per detyrimet e aksionareve jashte shoqerise.

Aksioneri i vetem perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltare.

#### Neni 10

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Aksionereve dhe vendimet e saj . Asambleja e Zakonshme e aksionerit thirret nje here ne vit . Kopetencat dhe pergjegjesite e Asamblese se Aksionereve percaktohen ne Statutin e Shoqerise .



**Neni 11**

**Keshilli Mbikqyres**

Organi qe ushtron kontroll te vazhdueshem mbi aktivitetin e shoqerise eshte Keshilli Mbikqyres. Ai zgjidhet nga Aksioneri i vetem dhe perbehet ;

1. Agron Musaraj
2. Arben Dervishaj
3. Vilson Goshi

Ne fillim te ushtrimit te aktivitetit Shoqeria mund te rrise numrin e anetareve te Keshillit Mbikqyres , per te siguruar pjesemarrjen ne masen 1/3 te tij nga ana e te punesuarve . Ne rast se nuk rritet numri i anetareve te Keshillit Mbikqyres , sigurimi i pjesemarrjes se te punesuarve do te behet brenda numrit tre te anetareve te Keshillit Mbikqyres

Kryetari i Keshillit Mbikqyres eshte z. Agron Musaraj  
Kopetencat e Keshillit Mbikqyres dhe Kryetarit te saj percaktohen ne Statutin e shoqerise anonime .

**Neni 12**

**Drejtimi i Shoqerise**

Drejtimi i shoqerise kryhet nga Drejtori i Pergjithshem qe eshte zoti Vasil Gjika . Kopetencat , detyrat si dhe pergjegjesite e tij percaktohen ne Statutin e Shoqerise .

**Neni 13**

**Dokumentimi , aktet**

Ne te gjitha aktet e shoqerise , dokumentat e saj te destinuar per te tretet , do te shenohen emrat e anetareve te Keshillit Mbikqyres dhe te Drejtorit te Pergjithshem te saj .

**NENI 14**

**PRISHJA E SHOQERISE**

Shpallet ne mbledhjen e jashtezakonshme te Aksionerit te Vetem.  
"WONDER" sh.a priset automatikisht me mbarimin e afatit sipas statutit  
"WONDER" sh.a mund te mbylle aktivitetin e tij perpara afatit te caktuar ne kontrate, kur:

- a) Aksioneri i vetem vendos per mbylljen.
- b) Aktiviteti rezulton me humbje per nje periudhe prej tre vitesh te rjepasnjeshem.
- c) Kur kapitalet e veta behen me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar.

Ne rast te mbylles se aktivitetit, ne cdo kohe ose per cdo arsye, Aksioneri i Vetem cakton menyren e likuidimit te tij dhe emerone nje ose me shume likuidatore, duke u percaktuar fuqite dhe kopetencat.

**NENI 15**

**DISPOZITA TË FUNDIT**

Te gjitha shpenzimet qe do te kryhen deri ne regjistrimin e shoqerise si person juridik do te perfshihen ne bilancin ekonomik te shoqerise.

Pjesë e pandarë e aktit të themelimit është Statuti, i cili do të nënshkruhet njëherazi nga themeluesi i "WONDER" sh.a

Aksioneri i Vetem eshte i detyruar brenda 5 ditesh nga data e firmosjes te kryejne derdhjen e pjeses se tyre te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kopetente per gjykimin e mosmarreveshjeve qe lidhen me shoqerine anonime eshte Gjykata e Rrethit Tirane .

**Ky Akt – Themelimi u shkrua, lexua dhe u firmos me vullnet te lire e ndergjegje te plote Aksioneri i Vetem para noterit në Tiranë, sot me datën 07.03.2001, në kater kopje ne gjuhen shqipe.**

AKSIONERI I VETEM

REPUBLICA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. Rep. 1103  
Nr. Kol. 67

PULLE TAKSE



VERTETIM

Sot, me date 24.03.2001 (dy mijë e një) para meje noterit publik u paraqit personalisht ortaku i vetem themelues i sipershenuar, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti e tij personal te identitetit te sipershenuar, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar njeshtes i gjuhes shqipe, siç e verej nga komunikimi i drejtperdrejte me te, i cili u shprehe se ka themeluar shoqerine tregtare "WANDER" sh.a. Akti i Themelimit eshte redaktuar jashte kesaj zyre dhe eshte perpiluar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe, pasi ai e nenshkruan ate ne prezencen time, une noterit e vertetoj nenshkrimin e tyre sipas ligjit.

**NOTERI**  
NOTERE  
ERMIRA RIZAJ  
Tel Fax 307-23

# STATUTI

SHOQERISE ANONIME

“WONDER” SH.A.



Aksionari i meposhtem ka themeluar shoqerine “WONDER” sh.a. konform Aktit te themelimit te kesaj shoqerie.

1. **Vasil Gjika**, lindur me 19.02.1955 ne Permet, banues ne Tirane ne ‘Rr. « Leke Dukagjini », Pallati Perballe INIMA-s, me shtetesi Shqiptare. dhe deklaroi se ka hartuar si me poshte vijon Statutin e Shoqerise Anonime pa oferte publike te emertuar : « **WONDER** » sh.a., te themeluar prej tij.

Shoqeria fiton Personalitetin Juridik nga dita e regjistrimit te tij ne gjykatën e rrethit Tirane. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe e zhvillon aktivitetin e tij ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe ato te akteve te tij themeluese (Statuti dhe Akti i Themelimit i Shoqerise).

## KREU I

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE KOHEZGJATJA

#### Neni 1:

#### **BAZUESHMERIA JURIDIKE**

Veprimtarine e tij, Grupi i Konsulences do ta zhvilloje ne baze te ketij statuti dhe te neneve 74-77, 89-93, 96-210 te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 ‘Per Shoqerite Tregtare’, vec atyre paragrafeve apo neneve qe nuk kane te bejne me kete forme shoqerie, si dhe te te gjithë legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

#### NENI 2

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

- Importimi , eksportimi dhe tregtimi me shumice dhe me pakice i te gjitha llojeve te artikujve .
- Zhvillimin e veprimtarise ne te gjitha fushat e ndertimeve, konstruksione, instalime , elektrike, hidrosanitare, ngrohje, rifinitura, etj , si dhe dhe tregtimin e te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit , elektrike, h/sanitare, ngrohje , etj..
- Projektimin dhe studimet ne te gjitha fushat e ndertimeve
- Projektimin dhe studimin ne fushen e urbanistikes .
- Zhvillimin e aktivitetit te investimit ne fushen e turizmit , transportit tokesor , ajror dhe detar
- Dhenia e konsulences dhe kryerja e sherbimeve ne lidhje me veprimtarite e mesiperme dhe ne te tjera .
- Studime te ndryshme feasibiliteti per projekte dhe investime ne sektore te ndryshem;
- Konsulence dhe asistence teknike per menaxhimin financiar te sipermarrjeve private dhe publike;
- Identifikim, hartim dhe zbatim projektesh e programesh ne nivel sipermarrjeje te vecante, qarku, kombetar dhe me ghere;
- Organizim ngjarjesh publike (seminare, workshop-e, kurse trajnimi, konferenca, etj.) per ceshtje te ndryshme te zhvillimit ekonomik, social, kulturor, politik; ndermarrje te fushatave te ndergjegjesimit publik, etj.



- Konsulence ne lehtesimin e operacioneve te ndryshme bankare, tregtare, industriale, financiare, te pasurive te tundshme ose te patundshme, etj.,
- Kryerjen e supervizionit , kolaudimit, dhe observimin e te gjitha operacioneve ne fushen e ndertimit dhe urbanistikes.
- Manaxhimin dhe tregetin e trojeve te ndertimit dhe pasurive te patundshme
- Peverc veprimtarive te parashikuara me lart , ne veprimtarine sipermarrese te Shoqerise do te hyje cdo veprimtari tjeter industriale , tregtare , financiare, turistike dhe ndertimi qe do te konsiderohet nga Asambleja e Aksionereve e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te Shoqerise .

**NENI 3:**

**VENDODHJA E SELISE SE SHOQËRISË**

Selia e Shoqerise eshte caktuar ne adresen : Rr. « L. Dukagjini », Pallati perballe INIMA-s, Tirane. Selia e shoqerise mund te transferohet kudo ne teritorin e Republikes se Shqiperise ne baze te nje vendimi te asamblese se pergjitheshme te jashtezakonshme te aksionareve.

**NENI 4:**

**KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqerise eshte mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtare në Gjykatën e Tiranës. Shkurtimi i kesaj kohezgjatjeje ne rastin e nje prishje te parakohshme ose zgjatje e afatit behen me vendim te jashtezakonshem te aksionarit te vetem.

**KREU II**

**KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET**

**NENI 5:**

**KONTRIBUTET NE KAPITAL**

Ne momentin e themelimit, Shoqerise i jane sjelle si kontribut ne para nje shume prej 12,000,000 (Dymbedhete milione) Leke qe i pergjigjet vleres nominale te aksioneve Nr. 1 deri ne Nr. 100, te gjitha ne para qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise. Aksionet jane te pandashme. Keto aksione jane nenshkuar teresisht dhe jane shlyer teresisht nga :

Nr	Emri Mbiemri	Nr. Aksioneve	Vlera Nominale	Kontributi ne Para
1	Vasil Gjika	100	120.000	12.000.000

i cili eshte i vetmi person firmoses i statutit. Shuma e derdhur nga aksioneri eshte ne natyre dhe e depozituar ne banke ose prane ndonje noteri dhe derdhjet jane evidentuar me nje certifikate te hartuar ne pajtim me ligjin.

**NENI 6:**

**KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 12.000.000 (dymbedhjet milion) Leke. Kapitali ndahet në 100 aksione, me vlerë nominale 120.000 lekë secili, tërsisht i derdhur dhe i numeruar nga 1 deri në 100. Kapitali aksionar mbulohet ne perqindje si me poshte :

1	Vasil Gjika	100%
---	-------------	------

**NENI 7:**

**NDRYSHIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

**A). ZMADHIMI I KAPITALIT**

Kapitali themeltare zmadhohet vetem me vendim te jashtezakonshem te Aksionerit te Vetem dhe ndryshimit te statutit ne baze te raportit te Drejtorit dhe te Ekspertit Kontabel.

Kapitali themeltar zmadhohet nepermjet:

1. Emetimit te aksioneve te reja ose;
2. Rritjes se vleres nominale te aksioneve ekzistuese.

Aksionet e reja shlyhen me para ne dore. Aksioneri ka te drejte perparesie ne nenshkrimin per kritjen e kapitalit me para ne dore proporcionalisht me shumen e aksioneve qe zoteron, çdo klauzole e kundert eshte e pavlefshme.

Zmadhimi i kapitalit themeltar duhet te realizohet brenda 5 vjeteve nga dita qe Aksioneri i Vetem ka miratuar kete zmadhim (Neni 153, ligji Nr. 7638/92).

#### **B). ZVOGELIMI I KAPITALIT**

Zvogelimi i kapitalit autorizohet ose vendoset nga Aksioneri i Vetem ne mbledhjen e tij. Ne Mbledhjen e Aksionerit te Vetem qe thirret per zvogelimin e kapitalit dorezohet raporti i arsyetuar i Drejtorit, duke shpjeguar arsyet qe e bejne te detyrueshme marrjen e vendimit perkates.

Ne te gjitha rastet, zvogelimi prek aksioneret ne te njejten mase, ne perpjestim me vleren e aksioneve qe zoterojne, ne baze te nenit 164 te ligjit 7638 /92.

Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar te pakten 45 dite perpara mbledhjes se Aksionerit te Vetem qe thirret per te vendosur mbi kete projekt.

#### **NENI 8:**

#### **SHLYERJA DHE VERIFIKIMI I KAPITALIT**

Nuk mund te merret vendim dhe te realizohet zmadhimi i kapitalit aksionar me para ne dore nese kapitali aksionar i deritanishem nuk eshte shlyer plotesisht. Ne rast te kundert operacioni i zmadhimit te kapitalit dhe leshimit te aksioneve te reja konsiderohet i pavlefshem ne baze te nenit 153 te ligjit 7638/92. Keshilli Mbikqyres, ne çdo rast te zmadhimit te kapitalit, duhet qe ne nje afat tre mujor nga realizimi i zmadhimit te kapitalit te verifikojë depozitimimin e kapitalit. Nese kapitali nuk eshte mbuluar plotesisht, atehere Keshilli Mbikqyres disponon lirshem aksionet e pambuluara tek te tretet ose kapitali aksionar shtohet deri ne shumen e mbulimit te tij.

#### **KREU III** **AKSIONET**

#### **NENI 9:**

Aksionet paraqiten ne formen e aksioneve nominative dhe jane te formes emerore.

#### **NENI 10:**

Aksionet jane te tregtueshme vetem me pelqimin e Asamblese se Pergjitheshme te Aksionereve.

#### **NENI 11:**

Me perjashtim te rasteve te trashegimise, aksionet tregtohen brenda shoqerise, duke ju shperndare aksionareve te tjere ne pjese te barabarta per te ruajtur raportet. Ne te gjitha rastet, kur behet blerja e tyre nga aksioneret e tjere te shoqerise, vlersimi i aksioneve do te behet nga nje ekspert i cili caktohet me mirekuptim nga palet. Ne raste se nuk bihet dakort, ai caktohet me vendim te gjykates. Ndryshimi i pronesise se aksioneve si rrjedhoje e nje shitje ose transferimi behet ne baze te nje urdher-kalimi ne rregjister.

#### **NENI 12:**

Transferimi i pronesise mbi aksionet tek nje person joaksionar, kur nuk realizohet tregtimi sipas nenit 11 te ketij statuti, pavaresisht nga baza juridike e ketij transferimi, duhet te miratohet me konsensus nga Keshilli Mbikqyres dhe Asambleja e Pergjitheshme e Aksionareve.



### **NENI 13:**

Aksionet janë të pandashme kundrejt shoqërisë e cila njih vetëm një pronar kryesor të një aksioni. Çdo aksion jep të drejtën e një vote. Një aksion nuk mund të ketë më shumë se një zotues.

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga çdo aksion i ushtron vetëm prurësi i tij i ligjshëm.

Aksionerët janë përgjegjës deri në kufirin e vlerës nominale të aksioneve që zoterojnë. Çdo kërkim fondesh përtej këtij kufiri është i ndaluar.

Çdo aksion i jep zotuesit të tij të drejtën e marrjes së një pjese nga fitimet e shoqërisë në përpjestim me kuotën - pjesë të kapitalit që ai përfaqëson, si dhe i jep zotuesit të tij të drejtën e votes dhe të përfaqësimit.

Aksioneri ushtron të drejtat e tij përpara i përket Drejtorit të Shoqërisë nëpërmjet Asamblesë së përgjithshme të Aksionerëve.

## **KREU IV** **ORGANET E SHOQËRISË**

Shoqëria drejtohet, organizohet dhe administrohet nga organet e tij që janë **Keshilli Mbikqyres dhe Drejtoria**.

### **KESHILLI MBIKQYRES**

#### **NENI 14:**

#### **KOMPETENCAT e KESHILLIT MBIKQYRES**

Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll të përhershëm dhe të vazhdueshëm ndaj Drejtorit dhe antarëve të tjerë të Drejtorisë për drejtimin dhe administrimin e shoqërisë nga ana e tij.

Keshilli Mbikqyres ka të drejtë të kryejë në çdo kohë të vitit verifikimet dhe kontrollet që i çmon të arsyeshme dhe të kërkojë të njihet me dokumentet që ai i gjykon të nevojshme për plotësimin e detyrës së tij.

Keshilli Mbikqyres vendos për operacionet që do të kryhen me autorizim të tij nga Drejtoria.

Keshilli Mbikqyres miraton strukturën organizative të shoqërisë dhe ndryshimet e saj, kriteret e punësimit dhe të pagave si dhe Rregulloren e Brendëshme të shoqërisë.

Drejtori i paraqet raport Keshillit Mbikqyres të paktën një herë në tre muaj.

Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar Drejtori i paraqet Keshillit Mbikqyres dokumentet që përcaktohen në nenin 130, paragrafi 2 të ligjit të sipërpermendur me qëllim verifikimi dhe kontrolli.

Keshilli Mbikqyres, në përputhje me nenin 130 të ligjit, i paraqet Asamblesë së Ortakëve vërejtjet e tij mbi raportin e Drejtorisë, si dhe ato mbi llogaritë e vitit financiar.

#### **NENI 15: PERBERJA**

Keshilli Mbikqyres përbëhet nga 3 antarë. Asnjë antarë i Keshillit Mbikqyres nuk mund të jetë Drejtor i Shoqërisë. Në rast se një antar i Keshillit Mbikqyres emërohet Drejtor atëherë mandati i tij në Keshillin Mbikqyres perfundon sapo ai të kalojë në funksionin e ri.


#### **NENI 16 :**

#### **EMERIMI I ANTAREVE TË KESHILLIT MBIKQYRES DHE KOHEZGJATJA**

Dy të tretat e Antarëve të Keshillit Mbikqyres emërohen me unanimitet nga mbledhja themeluese e Asamblesë së Aksionerëve ose nga mbledhja e zakonshme bazuar në nenin 105 të këtij ligji.

Një e treta e Antarëve të Keshillit Mbikqyres zgjidhet nga të punësuarit në Shoqërinë, bazuar në nenin 110 të ligjit. Mandati i anetarit të Keshillit Mbikqyres i zgjedhur nga të punësuarit është i papajtueshëm me çdo mandat tjetër përfaqësues të të punësuarëve të shoqërisë.

Antarët e Keshillit Mbikqyres aksionerë të emëruar nga Asambleja e Aksionerëve nuk mund të jenë të punësuar në shoqëri, me përjashtim të rasteve sipas nenit 109 të ligjit kur antarët e Keshillit Mbikqyres zgjidhen nga të punësuarit.



- 2 - 10

Kohezgjatja e funksioneve te antareve te Keshillit Mbikqyres eshte 6 vjet.  
Antaret mund te rizgjidhen edhe mbas ketij afati. Ata mund te shkarkohen ne çdo moment nga Asambleja e Aksionereve e zakonshme e aksionareve.

Çdo emerim i bete ne kundershtim me rregullat e mesiperme eshte i pavlefshem me perjashtim te rasteve kur veprohet ne kushtet e parashikuara nga neni 108 i ligjit per shoqerite tregtare.

Nje person juridik mund te emerohet ne keshillin mbikqyres. Ai duhet te caktojte nje perfaqesues te perhershem qe u nenshtrohet po atyre kushteve dhe detyrimeve dhe ka te njejtat pergjegjesi civile e penale sikur te ishte vete ai antare i keshillit, duke mos perjashtuar nga pergjegjesia e perbashket personin juridik qe ai perfaqeson. Personi juridik qe shkarkon perfaqesuesin e tij duhet te paraqese njekosisht zevendesuesin perkates.

Antareve te Keshillit Mbikqyres, me vendim te Asamblese mund t'u caktohet nje shperblim per pjesmarrije ne mbledhje ne nje shume vjetore fikse, kjo perballohet nga llogaria e shoqerise dhe kalon ne shpenzim te saj.

Keshilli Mbikqyres i pare qe do te drejtoje Shoqerine ka kete perberje:

1. Agron Musaraj
2. Arben Dervishaj
3. Wilson Goshi

#### **NENI 17:**

#### **KRYETARI DHE ZEVENDES-KRYETARI I KESHILLIT MBIKEQYRES**

Keshilli Mbikeqyres zgjedh nga gjiri i tij nje kryetar dhe nje zevendes-kryetar qe ngarkohen me mbledhjen e keshillit dhe drejtimin e debatit gjate seancave te tij.

Kryetari eshte person fizik dhe nuk mund te zgjidhet ndermjet perfaqesuesve te personave juridike.

Ato ushtrojne funksionet e tij gjate tere periudhes se mandatit te Keshillit Mbikeqyres.

Kryetar i pare i keshillit mbikqyres do te jete: z. Agron Musaraj

#### **DREJTORIA**

#### **NENI 18: EMERTIMI**

Shoqeria "WONDER" sh.a drejtohet nga Drejtoria. Drejtoria i ushtron funksionet e tij nen kontrollin e Keshillit Mbikqyres.

Emerimi i Drejtorise behet nga Keshilli Mbikqyres.

Drejtori eshte person fizik ne te kunderten emerimi i tij eshte i pavleshem. Keshilli mbikeqyres mund te zgjidhe Drejtorin dhe antaret e Drejtorise edhe jashte grupit te aksionereve.


Drejtor i Pergjithshem i Shoqerise "WONDER" sh.a. do te jete: z. Vasil Gjika.

#### **NENI 19:**

#### **SHKARKIMI I DREJTORIT DHE ANTAREVE TE DREJTORISE**

Drejtori dhe antaret e Drejtorise mund te shkarkohen per shkaqe te perligjura nga Keshilli Mbikqyres sipas nenit 98 te ligjit 7638/92. Si shkaqe te perligjura konsiderohen vecanerisht fajet e renda te Drejtorit dhe antareve te Drejtorise, si paaftesia e tyre ne kryerjen korrekte te funksioneve, kur Asambleja humbet besimin tek kjo Drejtori, si dhe kur derntohen interesat e shoqerise.

Perjashtohen rastet kur shkarkimi eshte i nxitur haptazi nga shkaqe qe s'kane te bejne me interesat e shoqerise. Shkarkimi mbetet ne fuqi derisa vendimi gjyqesor qe evidenton pavleshmerine e shkarkimit te marre fuqi ligjore.



**NENI 20:**

**KOHE ZGJATJA E MANDATIT TE DREJTORIT DHE ANTAREVE TE DREJTORISE**

Kohezgjatja e mandatit te Drejtorit dhe antareve te tij caktohet 4 vjet.

Asambleja e Pergjithsheme e Jashtezakonshme ka te drejte te ndryshoje kohezgjatjen e mandatit te drejtorise te caktuar ne statut, ta zgjase ose ta shkurtoje ate.

Kur nje ose me shume vende ne Drejtori mbeten bosh, Keshilli Mbikqyres emerone zevendesues deri ne mbarimin e mandatit te Drejtorise.

**NENI 21:**

**SHPERBLIMI I ANETAREVE TE DREJTORISE**

Menyra dhe masa e shperblimit te secilit anetar te drejtorise caktohet nga Keshilli Mbikqyres ne aktin e emerimit.

**NENI 22:**

**KOMPETENCATE DREJTORISE DHE MARRJA E VENDIMEVE NGA ANA E TIJ.**

Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne çdo rrethane ne emer te shoqerise. Ajo i ushtron keto kompetenca brenda objektit te shoqerise, por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji ua jep shprehimisht keshillit mbikqyres.

Shoqeria, ne marrredhenie me te tretet, merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e Drejtorise edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e veprimtarise se drejtorise.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj tretteve, kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i Drejtorise e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Me autorizim te Keshillit Mbikqyres, antaret e Drejtorise ndajne midis tyre detyrat per drejtimin e shoqerise.

Drejtoria kerkon autorizim paraprak te Keshillit Mbikqyres per veprimet e meposhtme:

- Dhenia e dorezane dhe garancive.
- Kryerja e investimeve tej atyre te parashikuara ne programin financiar vjetor.
- Hapja e veprimtarise ose e degeve te reja, shkrija bashkimi dhe mbyllja teresisht ose pjeserisht e veprimtarise dhe degeve te shoqerise.
- Pjesmarrja ne shoqeri te tjera te krijuara ose per t'u krijuar
- Shitja dhe shkembimi i pasurive qe perbejne aktive te qendrueshme te shoqerise.
- Negocimi, perfundimi a ndryshimi i çdo kontrate me afat te gjate ose per nje shume mbi kufijte e caktuar çdo vit nga Keshilli Mbikqyres.

**Neni 23:**

**PERFAQESIMI TEK TE TRETET**

Shoqeria perfaqesohet ne marrredhenie me tretet nga Drejtori i tij. Ankesat apo kerkesat qe te tretet i adresojne shoqerise, jane te vleshme kur ato dergohen tek Drejtori. Drejtori ka te drejten te ngarkoje me kompetencen e perfaqesimit nje anetar tjeter te drejtorise per disa operacione specifike ose per disa kategori specifike operacionesh. Dispozitat e statutit qe kufizojne kompetencat e perfaqesimit te shoqerise, duhet te respektohen nga te tretet.

**KREU V**

**ASAMBLEJA E AKSIONEREVE**


**NENI 24:**

Asambleja e Aksionereve eshte organi me i larte i shoqerise dhe vendose per çdo çeshtje. Vendimet e Asamblese se Aksionereve jane angazhuese per aksioneret.

Vetem Asambleja e Jashtezakonshme ka te drejten e ndryshimit te statutit ne lidhje me te gjithë dispozitat e tij.

Çdo kusht tjeter konsiderohet i pavlefshem.

Vendimet e Asamblese se Pergjitheshme merren me shumicen e  $\frac{3}{4}$  te votave te perfaqesuara te aksionereve.



### **NENI 25:**

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim, përveç atyre që refrohen në nenin 128 të ligjit 7638/92.

Asambleja e zakonshme merr vendim në mënyrë vendimtare për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shoqërinë.

Asambleja e zakonshme mbledhet një herë në vite ose brenda 6 muajve mbas mbarimit të vitit financiar.

Asambleja shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet e vitit financiar që mbylle. Ajo ushtron kompetencat që kanë bazë në nenin 105, 108, 109, 123, dhe paragraf 3 I nenit 125 të ligjit 7638/92.

### **NENI 26:**

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga Këshilli Mbikqyres ose Drejtoria. Në mungesë të tyre thirret :

- a) Nga eksperti kontabel i autorizuar.
- b) Nga personi i autorizuar nga gjykata mbas kërkesës të çdo të interesuari për një rast urgjent ose të një ose disa aksionarëve që zoterojnë 1/10 e kapitalit.
- c) Nga likuidatori.

Mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve realizohet ashtu siç përcaktohet nga ligji.

### **NENI 27:**

Çdo aksioner mund të përfaqësohet vetëm nga një aksioner tjetër ose nga e shoqja /I shoqi.

Antaret e Këshillit Mbikqyres dhe të Drejtorisë kur janë aksionar marrin pjesë me votë vendimtare.

Çdo aksioner ka të drejtë të informohet për të gjitha çështjet që parashikohen në nenin 143 të ligjit 7638/92

## **KREU VI KONTROLLI I SHOQERISE**


### **NENI 28: EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR**

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga një Ekspert Kontabel i Autorizuar i cili emrohet për 1 vit financiar. Detyrat e Ekspertit Kontabel do të realizohen në përputhje me nenin 178, 179 dhe 180 të Ligjit 7638/92. Funkcionet e tij perfundojnë pas mbledhjes së asamblesë së zakonshme.

Ekspertet kontabel të autorizuar janë përgjegjës si ndaj shoqërisë ashtu dhe ndaj të tretëve për pasojat e demshme që rrjedhin nga fajet dhe nënvlefësimet e tyre në ushtrimin e funksioneve përkatëse sipas nenit 184 të ligjit.

### **NENI 29:**

- Ekspert kontabel i shoqërisë është z. **Berti Pashko**.





### **NENI 30:**

Asambleja e Pergjitheshme do te emeruje nje Kontrollor i cili ka cilesine e ekspertit kontabel te miratuar dhe e ngarkon me keto detyra:

- Mbatjen e llogarive te shoqerise ne menyre qe ato te jene sipas parimeve baze te kontabilitetit.
- Pergatit raportin vjetor te te dhenave ekonomike dhe shpreh mendimin nese te dhenat ekonomiko-financiare reflektojne realitetin e gjendjes ekonomiko-financiare te shoqerise.
- Informon keshillin mbikqyres ne lidhje me ndonje parregullesi te mundeshme qe vihet re ne shkembimet, procedurat, aktivet ose llogarit e shoqerise te cilat do te mund te çonin ne ekzistencen e humbjeve per shoqerine.

### **NENI 31:**

Kontrolluesit e autorizuar kane per detyre te mbikqyrin llogarite vjetore te cilat duhet te jene te perpiluara ne baze te ligjit per kontabilitetin dhe te shprehin me saktesi rezultatet e periudhes ushtrimore si dhe te japin me sinqeritet dhe rezultatit e dale ne fund te vitit financiar. Kontrolli i brendshem ka dhe kompetencat qe percaktohen nga nenet 178, 179, 180 dhe 182 te ligjit 7638/92

### **NENI 32:**

Ne fund te çdo viti financiar keshilli mbikqyres bene regjistrimin (inventarin) dhe llogarite vjetore ne baze te dispozitave te ligjit ne fuqi per Kontabilitetin, si dhe perpilon raportin per Administrimin.

## **KREU VII**

### **REZERVAT E DOMOSDOSHME, NDARJA E FITIMEVE DHE DEVIDENTET**

#### **NENI 33:**

Kapitali rezerve krijohet ne masen 5 % te fitimit neto pasi me perpara te jene zbritur humbjet e mundeshme te viteve te meparshme.

#### **NENI 34:**

Fitimet qe do te ndahen, perbejne fitimet e bilancit mbasi do te jene zbritur rezervat dhe humbjet e mundeshme te viteve te meparshme, ne baze te nenit te mesiperem.

#### **NENI 35:**

Mbas miratimit te bilancit vjetore dhe regjistrimin e shumes qe do te ndahet. Asambleja e pergjitheshme cakton shumen qe do te ndahet tek aksionaret ne formen e devidenteve ne baze te neneve 215, 216 te ligjit 7638/92 (ne baze te kapitalit aksionar)

## **KREU VIII**

### **PRISHJA E SHOQERISE**

#### **NENI 36:**

Shpallet ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme.

Shoqeria priset automatikisht me mbarimin e afatit sipas statutit

Shoqeria mund te mbylle aktivitetin e tij perpara afatit te caktuar ne kontrate, kur:

- a) Aksioneret vendosin me marreveshje per mbylljen.
- b) Aktiviteti rezulton me humbje per nje periudhe prej tre vitesh te njepasnjeshem.
- c) Kur kapitalet e veta behen me te vogla se gjysma e kapitalit themeltare

Ne rast te mbylljes se aktivitetit, ne cdo kohe ose per cdo arsye, Asambleja e Aksionereve cakton menyren e likuidimit te tij dhe emerone nje ose me shume likuidatore, duke u percaktuar fuqite dhe kompetencat. Likuidimi i shoqerise behet ne baze te dispozitave qe percaktohen nga ligji.



**NENI 37:  
MOSMARVESHJET**

Kopetente per gjykimin e mosmarveshjeve qe lidhen me shoqerine anonime eshte Gjykata e Rrethit Tirane .

**NENI 38: DISPOZITA TË FUNDIT**

Per çeshtje qe nuk parashikohen ne kete statut dhe gjate themelimit te Shoqerise zbatohen dispozitat ne fuqi te ligjit per Shoqerite anonime pa oferte Publike

*Ky Statut u shkrua, u lexua dhe u firmos me vullnet te lire e ndergjegje te plote nga aksioneri para noterit në Tiranë, sot me datën 07.03.2001, në tre kopje ne gjuhen shqipe*

AKSIONERI THEMELUES:

VASIL GJIKA